



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
**Kuvendi - Skupština - Assembly**

---

**Legjislatura IV**

**Sesioni pranveror**

Komisioni i Shëndetësisë, Punës dhe Mirëqenies Sociale

Mbledhja nr. 43

Prishtinë, më 21 qershor 2012, në orën 13: 00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-302

**P R O C E S V E R B A L**  
**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR SHËNDETËSI, PUNË**  
**DHE MIRËQENIE SOCIALE**

**Në mbledhje morën pjesë:** Fikrim Damka, Nazane Breca, Time Kadrijaj, Bahri Thaçi, Sasha Gjokiq, Liburn Aliu, Salihe Mustafa, Gëzim Kelmendi.

**Mungoi:** Flora Brovina.

**Të pranishëm:** Bekim Haxhiu-deputet, Aurora Bakalli-deputete, Shpresa Haxhijaj- administratore e Komisionit; Enis Halimi – zyrtar i fushës për shëndetësi; Florie Kryeziu- UNICEF.

**Mbledhjen e kryesoi,** Fikrim Damka- kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky  
rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 06.06.2012 dhe 13.06.2012;**
- 3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Ferid Agani;**
- 4. Të ndryshme.**

***Kryesuesi** konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me shqyrtimin e pikës së parë të rendit të ditës.*

**1.Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

**2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e datave 06.06.2012 dhe 13.06.2012**

*Kryesuesi konstatoi se procesverbali nga mbledhjet e datave 06.06.2012 dhe 13.06.2012 u miratuan pa vërejtje.*

### 3. Takim me ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë, z. Ferid Agani

**Fikrim Damka-** E falënderoi ministrin për prezencën e tij në Komision dhe ia dha fjalën për diskutim.

**Ferid Agani-** Tha se edhe në të kaluarën ka qenë anëtar i grupeve punuese në hartimin e Ligjit të shëndetësisë. Ky Ligj i shëndetësisë do të mundësojë fillimin e reformës. Ky sistem që e kemi, është fajtor për gjendjen që e kemi, sepse ky është një sistem emergjent dhe nuk i reflekton nevojat që i ka shëndetësia në Kosovë. Reforma do të zbatohet në 2 faza. Faza e parë fillon me këtë Ligj. Faza e dytë fillon me miratimin e Ligjit për sigurime shëndetësore. Koha se kur do të miratohet Ligji për sigurime shëndetësore do të varet nga shumë faktorë. Projekti reformues është i dakorduar në tërësi me FMN-në dhe BB-në, të cilët do të na përkrahin në këto ndryshime. Sa i përket sigurimeve, jemi ende duke diskutuar për mënyrën e mbledhjes së këtij fondi. Reforma do të ketë nevojë për një bashkëveprim funksional dhe një punë tejet të madhe. Parashihen ndryshime në tërë sistemin shëndetësor, sidomos në nivelin sekondar dhe terciar. Me këtë Ligj do të themelohet Shërbimi Shëndetësor i Kosovës, i cili do të ketë statusin e ndërmarrjes publike joprofitabile. Kjo ndërmarrje do të ketë bordin drejtues. Autonomia menaxheriale e institucioneve shëndetësore do të jetë e lartë. Në këtë Ligj përmendet edhe agjencia e financimit të shëndetësisë. Me këtë Ligj do të parandalohet konflikti i interesit, duke i ndarë punëtorët në ata që punojnë në institucione private dhe në ata që punojnë në institucione publike. Mjekët që punojnë në institucione publike do të stimulohen në formë të ndryshme. Tash e kemi problemin e ikjes së kuadrove të reja nga Kosova, sepse nuk po kemi mundësi që të punësohen ato kuadro. Ligjin për sigurime shëndetësore do ta miratojmë në vitin 2013, ndërkaq më 2014 do ta kemi fondin funksional.

**Fikrim Damka-** Pyeti ministrin: A keni biseduar me ministrin e Financave për mbështetjen financiare për këtë Ligj në vitin 2013?

Ndërmarrja publike që do të themelohet, a do të subvencionohet nga Qeveria?

**Ferid Agani-** Duke u përgjigjur, tha se miratimi i këtij Ligji ka zgjatur shumë, sepse kemi pasur konsultime të gjata me FMN-në dhe BB-në. Ministria e Financave është zotuar se do ta përkrahë secilën zgjidhje që ne ofrojmë, e cila është e përkrahur nga FMN-ja dhe BB-ja. Shëndetësia do të ketë 20 milionë euro më shumë në vitin 2013. Modeli i financimit do të jetë mikst, si nga Qeveria, e po ashtu edhe nga fondi që do të themelohet.

**Time Kadriaj-** Tha se drafti final i projektligjit ka pësuar ndryshime të mëdha. Na trego se ku ka pësuar ndryshime ky draft, sepse edhe sindikata e shëndetësisë ka vërejtje të shumta në këtë drejtim.

**Ferid Agani-** Tha se unë nuk kam informata që sindikata ka vërejtje. Në fillim, ne kemi menduar që ta bëjmë reformën me një hap të madh, por gjatë konsultimeve me FMN-në dhe BB-në, nuk kemi arritur t'i bindim ata që ta bëjmë një gjë të tillë. Zgjidhjet që janë dhënë, nuk janë ndryshime të mëdha. Ne kemi provuar të gjejmë zgjidhje joradikale. Ndryshimi ka të bëjë me ndalimin e punëtorëve që të punojnë në të dy sektorët, publik dhe privat njëkohësisht, si dhe sistemin e bashkëpagesave. Ky Ligj do të mundësojë shërbime pa pagesë për qytetarët që kanë nevojë. Bashkëpagesat do të hiqen kur të fillojë funksionimi i fondit.

**Salihe Mustafa-** Tha se në projektligj shihet se përmenden odat e profesionistëve shëndetësorë. Është vështirë që të votojmë një ligj me këto kompetenca që u jepen odave, derisa nuk e kemi Projektligjin për odat e profesionistëve shëndetësorë. Thuhet se odat janë përgjegjëse edhe për specializime. Dua një sqarim lidhur me këtë.

**Ferid Agani-** Duke u përgjigjur, tha se nuk ka kompetenca shumë specifike për odat në këtë Projektligj. Kompetencat e odave do të jenë sikur në secilin shtet tjetër. Askush më mirë se profesionistët nuk kujdesen më mirë për shëndetësinë.

**Aurora Bakalli-** Tha se reformat në shëndetësi kanë qenë të domosdoshme. Dilema është se a do të mund ta mbajë veten sistemi shëndetësor i reformuar. Si do të veprohet në rast se nuk ka mjete të mjaftueshme, sidomos në fazën e fillimit? Ndarja e punës në sektorin privat dhe publik, ndoshta do ta përmirësojë punën, por si e keni marrë këtë vendim kur ju keni thënë që ka rrezik nga Gjykata Kushtetuese që ta rrëzojë këtë Ligj si antikushtetues. Me këto ndryshime të parapara, duhet numër shumë më i madh i inspektorëve shëndetësorë.

**Ferid Agani-** Tha se sistemi shëndetësor do ta mbajë veten, madje më mirë se deri më tash. Situata nuk mund të përkeqësohet. Jam i bindur se do të ketë gjenerim të madh të mjeteve në sistemin tonë shëndetësor. Probleme me ndarjen e sektorit publik dhe privat ka pasur edhe në shtete të tjera. Kjo është punë e Gjykatës Kushtetuese, ta japë mendimin e vet, nëse ngrihet kjo çështje në këtë instancë. Me koston e projektligjit, është paraparë që të punësohen mbi 400 punëtorë të rinj. Ligji parasheh që të punësohen për çdo vit nga 300 mjekë të rinj dhe 100 specialistë të rinj. Këtu do të rritet edhe numri i inspektorëve shëndetësorë.

**Bahri Thaçi-** Tha se ligji do të ketë efekte. Duhet të jemi të kujdesshëm që të dy sektorët t'i trajtojmë njëjtë, si atë publik, po ashtu edhe atë privat. Çka do të ndodhë me ata mjekë të cilët punojnë vetëm në sektorin privat?

**Ferid Agani-** Tha se në të ardhmen, kur të themelohet fondi, do të kontraktohen edhe ata në sektorin privat. Do të ketë vetëm përmirësim të gjendjes aktuale dhe jo keqësim të saj.

**Liburn Aliu-** Tha se në fillim është thënë se ky Ligj do të vijë së bashku me atë të sigurimeve. Por, siç po shihet, Ligji për sigurime nuk është afër. Kur do të vijë Ligji për sigurime shëndetësore? Te neni 41, cilat janë masat që parashihet të ndërmerren që të ketë sukses një propozim i tillë? Jam skeptik për SHSHK si ndërmarrje me bord dhe mendoj se në këtë fazë duhet të ketë një kontroll më të madh nga Ministria, sepse kështu do të ketë një dekompozim të sistemit shëndetësor. Në nenin 7 përmendet mbikëqyrja profesionale. Kjo mbikëqyrje nuk duhet të lihet tek Ministria, por tek personat profesionalë të licencuar për atë punë. Në nenin 49, sistemi i informimit shëndetësor thuhet se do të mbikëqyret nga këshilli i SISH-it. Kjo nuk mund të jetë kështu, sepse kjo i bie që SISH-i ta mbikëqyrë SISH-in. Jam skeptik sa i përket funksionimit të sistemit në këtë mënyrë. Reformimi në shtetet që kanë pasur zhvillim të hovshëm në shëndetësi, është bërë kur shteti ka marrë më shumë kompetenca në këtë drejtim.

**Ferid Agani-** Duke u përgjigjur, tha se kjo reformë është një proces i konsultuar nga MSH, me FMN-në dhe BB-në. Ne nuk mund të hyjmë në reformë, pa mbështetjen e këtyre faktorëve. Shëndetësia ka qenë jashtë planeve të këtyre faktorëve. Një problem i krijuar për 30 vite, nuk mund të zgjidhet brenda një kohe të shkurtër. Ne mund ta miratojmë edhe tash Ligjin për sigurime, por për mua është e pakuptimtë që ai të mos zbatohet kur të miratohet. Ne e kemi përpiluar pakon e shërbimeve, çmimoren e shërbimeve dhe SISH-in e kemi gati rreth 40 %. Mendoj se në vitin 2013 duhet të fillojmë kontraktimin e shërbimeve dhe kështu t'i bindim faktorët e përmendur se ne dimë t'i shpenzojmë me plan paratë e mbledhura. Inspektorati dhe odat e profesionistëve do të parandalojnë konfliktin e interesit dhe do të mundësojnë implementimin e plotë të këtij Ligji. Një numër i vogël do ta lëshojnë sistemin publik. Pjesa tjetër do të vazhdojë të punojë, por do të shikojnë se si do të fitojnë më shumë. Janë paraparë 4.5 milionë euro për stimulim të personelit shëndetësor. Një model i decentralizuar ka ekzistuar edhe më herët tek ne. Skepticizmi është pozitiv kur është konstruktiv.

**Nazane Breca-** E pyeti ministrin: Si do të zgjidhet bordi i SHSHK-së? Në këtë Ligj e kemi një përzierje të shërbimeve. Në kujdesin parësor parashihet edhe qendra e të dëgjuarit dhe e të folurit. Në

ligj thuhet se IKSHPK është përgjegjës për hartimin e protokolleve të trajtimit. Mendoj se ato duhet të hartohen nga profesionistët shëndetësorë.

**Ferid Agani-** Duke u përgjigjur, tha se bordi emërohet nga ministri. Kompetencat e bordit përcaktohen me rregullore. Jemi të interesuar për një autonomi sa më të madhe të institucioneve brenda sistemit. Modeli i funksionimit do të jetë horizontal. Secili spital do të jetë i specializuar më shumë për një problematikë. IKSHPK do të jetë mbikëqyrës i zbatimit të protokolleve të hartuara dhe do të fuqizohet roli i institutit. Edhe SISH-i duhet të jetë në IKSHP.

**Bekim Haxhiu-** Tha se gjendja në shëndetësi nuk është e mirë. Shqetësimi im ka të bëjë me atë se a do t'i humbim profesionistët e mirëfilltë, nëse i kushtëzojmë që të punojnë ose në sektorin publik, ose në atë privat. Kjo do të ndodhë sidomos me ata që janë të angazhuar me punë edhe në Fakultetin e Mjekësisë. A keni menduar që të mundësoni një pagë të integruar, që do të shërbente si motivim për ata që të vazhdojnë të punojnë në sistemin publik shëndetësor? Ne duhet t'i decentralizojmë shërbimet shëndetësore. Por, do të ishte mirë që të definohen më mirë këto gjëra dhe të mos lihet mundësia për keqpërdorime eventuale. Bashkëpagesat a janë në harmoni me Ligjin për financat publike?

**Ferid Agani-** Tha se ekziston një rrezik për ikjen e kuadrit nga sistemi publik. Nuk mund të ketë më pagë të dyfishtë në QKUK. Kjo çështje rregullohet nga SHSHK-ja, e cila është ndërmarrje publike. Paga e integruar është një opsion shumë real. Me mënyrën e funksionimit të sistemit të reformuar, do të shkarkohet edhe lista e të punësuarve në sektorin publik. Kjo do të mundësonte punësimin e më shumë kuadrove në shëndetësi.

**Time Kadriaj-** Tha se punëtorët e Inspektoratit Shëndetësor, janë kthyer në shërbyes civilë dhe u është zvogëluar edhe paga. Kujt i përgjigjet Inspektorati Shëndetësor? A është konflikt i interesit që edhe kryeinspektori të dalë në terren për inspektim, kur dihet se shkalla e parë e ankesës së palës është kryeinspektori? Inspektorëve nuk po u paguhet rrezikshmëria në punë.

**Ferid Agani-** Duke u përgjigjur, tha se rrezikshmëria është kthyer dhe tash do t'u paguhet. Ne jemi konsultuar me Zyrën ligjore të Qeverisë dhe na është thënë se inspektorët janë shërbyes civilë. Ankesa në shkallën e parë realizohet në organin që e ka nxjerrë vendimin, e shkalla e dytë realizohet nga komisioni që e cakton sekretari i përgjithshëm.

#### **4. Të ndryshme**

**Fikrim Damka-** Tha se duhet të bisedojmë me Kryetarin e Kuvendit, për mundësinë e hartimit të një amendamenti për shpërndarjen e rritjes së pensioneve me një vendim të Qeverisë.

**Nazane Breca-** Tha se, nga takimi që kemi pasur, ministri u tha pensionistëve se së pari duhet të miratohet ligji, e më pas të merret rritja e paraparë.

**Liburn Aliu-** Tha se janë dy rekomandime, njëri emergjent dhe tjetri afatgjatë sa i takon Ligjit të pensioneve. Ne duhet ta qesim në Kuvend rekomandimin, sepse Kuvendi e obligon Qeverinë.

#### **E përgatiti:**

**Njësia për Mbështetjen e Komisionit.**

**Kryetari i Komisionit**

---

**Fikrim Damka**